



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 70/2 prot.,

Datë 12.01.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “DAJTI PARK 2007” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-91129-12-15-2023, me objekt “*FURNIZIM DHE SHËRBIME ME USHQIM PËR MËNCËN*”, me fond limit 2.791.328. lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Qendra Komunitare Multidisiplinare Tiranë.

Ankimues: “DAJTI PARK 2007” SHPK, me Nipt. K11507003S.
Adresa: Rruga: “Bardhok Biba”, Pallati Trema, Hyrja C, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Qendra Komunitare Multidisiplinare Tiranë
Adresa: Rruga ‘Maliq Muco ‘nr.19 ,Tiranë.

Në datën 11.01.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 70/2024 prot. e operatorit ekonomik “DAJTI PARK 2007” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-91129-12-15-2023, me objekt “*FURNIZIM DHE SHËRBIME ME USHQIM PËR MËNCËN*”, me fond limit 2.791.328. lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Qendra Komunitare Multidisiplinare Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues “DAJTI PARK 2007” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:
b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar”.

Komisioni i Prokurimit Publik, do të publikojë arsyet e skualifikimit, të cilat operatori ekonomik ankimues “DAJTI PARK 2007” SHPK, kundërshton në ankesën e ardhur më datën 11.01.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me nr. 70/2024 Prot.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

- *Pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik Dajti Park 2007, shpk, Rezulton se nuk është plotësuar pika 2.3 .7 Kapaciteti Teknik sipas DST, 2.3.7-b DHE 2.3.7-c, Operatori ekonomik nuk ka provuar se disponon lejen nga QKL për pelqim mjedisor për aktivitetin e gatimit dhe shperndarjes se ushqimit, si dhe lejen higjeno-sanitare për objektin në fjale. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.7 sipas DST, pikën b dhe c*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 12.01.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Anila Malaj

Anëtar

Kreshnik Ternova

Nënkryetar

Fiorent Zguro